

RELACION

PËR PROJEKT-URDHRIN E KRYEMINISTRIT

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.88, DATË 25.10.2011 TË KRYEMINISTRIT “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, TË NDRYSHUAR

Ndryshimet në Urdhrin nr.88, datë 25.10.2011 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror, të ndryshuar, propozohen nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Projekt-Urdhri është hartuar në kuadër të procesit të Deinstitutionalizimit, proces i cili ka filluar që me miratimin e Vendimit nr. 706, datë 09.09.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit (PKD) 2020-2022, dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij. Për të siguruar zbatimin e këtij plani kombëtar me Urdhër të Ministrit Nr. 548/2020, i ndryshuar u ngrit Komiteti Drejtues, me përfaqësues të të gjithë aktorëve pjesëmarrës në këtë proces, i cili, mori vendimin, janar 2023, për vijimësinë e Planit të Veprimit për Zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, për vitin 2023.

Në këtë kontekst, një nga nismat e ndërmarra në kuadër të vijimësisë së procesit të deinstitutionalizimit është pilotimi i planit të transformimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror për fëmijë 0-5 vjeç në Bashkitë Vlorë dhe Korçë, struktura e të cilave është e miratuar me Urdhrin Nr. 88, datë 25.10.20211 e Kryeministrit “Për miratimin e strukturës së Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar.

Plani i transformimit ruan buxhetin dhe burimet njerëzore aktuale. Transformimi kupton kalimin nga shërbim rezidencial në shërbim të kujdesit alternativ, ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror, për mbështetjen e fëmijës dhe familjes.

Projekt-Urdhri mundëson realizimin e procesit të transformimit të tipologjisë së shërbimit që do të ofrohet në qendrat e institucioneve të përkujdesit shoqëror, pranë Bashkive Korçë dhe Vlorë, nga qendra rezidenciale për fëmijë të grupmoshës 0-5 vjeç në qendra të shërbimeve për mbështetjen e fëmijës dhe të familjes, që do të përfshijë:

1. Shërbimet e fuqizimit të familjes;
2. Shërbimet e specializuara adresojnë çdo nevojë specifike individuale të fëmijës dhe familjes;
3. Shërbimet mbështetëse për kujdesin alternativ;
4. Shërbimet e mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve në situatat e emergjencës (72 orë - 6 muaj);
5. Shërbimet mbështetëse në familje.

Projekt-Urdhri ka në përmbajtje 4 pika.

Në pikën 25 të Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes”.

Në pikën 26 të Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes”.

Në Skemën 2/18 bashkëlidhur Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës Korçë” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Korçë”.

Në Skemën 2/19 bashkëlidhur Urdhrit, togfjalëshi “Organika e Shtëpisë së Foshnjës Vlorë” zëvendësohet nga togfjalëshi “Organika e Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes Vlorë”.

PROPOZUESI

MINISTËR

Albana Kociu

